

Ditari Naturës

"Ky botim është bërë i mundur nga një grant i REC Shqipëri në kuadër të programit SENIOR-A "Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri". Ky program është financuar nga Qeveria Suedeze"
Nr. 31 Viti i tretë i botimit Dhjetor 2015

Në këtë numër do të gjeni:

- ... me këtë rast Ju kujtojmë se ...
- Edukimi Mjedisor si komponent i projektit të SeaMed-it
- Mblidhet Komiteti Drejtues i projekteve MedPartnership dhe ClimVar&MIZB
- INCA merr pjesë në Konferencën "The State is us"
- Raport Progresi për Shqipërinë - më shumë vëmendje ndaj mjedisit
- Raport mbi vlerësimin e VNM-ve të hidrocentraleve në Europën Juglindore
- Njoftime

... me këtë rast Ju kujtojmë se 20 vjet më parë ...

...me Urdhër të Ministrisë së Bujqësisë nr.2, dt.26.12.1995, territori lagunor, pyjet aluvional dhe pjesë e dunave ranore të Rrushkullit-Rrotull, me sipërfaqe 650 ha, ri shpallet Rezervat Gjuetie, i shpallur për herë të parë në dt. 07.07.1956, me sipërfaqe 1286 ha. Me udhër nr.404, dt. 25.01.1983, sipërfaqja e rezervatit të Rrushkull-Rrotull zvogëlohet në 700 ha, duke hequr sipërfaqen e Rrotullës.

Pas miratimit të ligjit për Zonat e Mbrojtura ky rezervat u njehësuar me statusin, sipas IUCN, "Rezervat Natyror i Menaxhuar".

Vijon në faqe 2

Ura e Katiut, Përmet © Foto INCA



Organizatat partnere të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës



SHOQATA MJEDISORE CAJUPI
Bashkejeto me Natyrën



QENDRA RAJONALE E MJEDISIT
Shqipëri



Mbështetje për Organizatat Mjedisore
të Shoqërisë Civile në Shqipëri



SWEDEN

Vijon nga faqe 1 Gjendja është tepër e rënduar, përshkak se ky territor është dhënë për mbarështimin e faunës së egër. Në fakt aty rriten në kushte jo normale edhe kafshë e shpendë që nuk i takojnë këtij rezervati, pra ka humbur funksionet dhe statusin e ZM të Menaxhuar...

... 13 vjet më parë ...

...me VKM nr.676, **dt.20.12.2002**, shpallen “ZONË E MBROJTUR” 750 njësi Bio dhe Gjeo Monumente të Natyrës Shqiptare...

... 7 vjet më parë ...

...me VKM nr.1631, **dt.17.12.2008**, ekosistemi natyror-malor i Bredhit të Hotovës-Dangëlli, me sipërfaqe 34,361.1ha, shpallet Park Kombëtar me sipërfaqe të zgjeruar, pasi në të u përfshi dhe territori, kryesisht bredhishtja, me sipërfaqe prej 4200 ha i “Bredhit të Hotovës”, i shpallur park kombëtar, me VKM nr. 102, datë 15.01.1996. Për këtë park kombëtar, me mbështetje të IPA10, nëpërmjet projektit SELEA, është hartuar dhe Plani i Menaxhimit, i cili deri më sot nuk ka gjetur zbatim.

Me shqetësuese për menexhimin e parkut është ndërtimi i HEC-ve, veçanërisht ai mbi lumin e Langaricës, i cili cënon rëndë kanionin dhe ujërat termale të Bënjës.

... 4 vjet më parë ...

...me VKM nr.898, **dt.21.12.2011**, ekosistemi natyror-malor i Korab-Koritnikut, me sipërfaqe 55,550.2 ha, të shtrirë në qarkun e Dibrës dhe të Kukësit, shpallet “Park Natyror”. Me mbështetje të IPA10, nëpërmjet projektit SELEA, është hartuar dhe Plani i Menaxhimit, i cili deri më sot nuk ka gjetur zbatim. Me shqetësuese për menexhimin e parkut është ndërtimi i HEC-ve, veçanërisht mbi lumin e Lumës dhe të Radomirës.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), me strukturat e vartësisë, ka detyrë dhe duhet të drejtojnë vëmendjen dhe të jetë më e kujdesshme në evidentimin dhe marrjen e masave për njohjen, ruajtjen dhe mirëmenaxhimin e këtyre pasurive me vlerë të lënë në harresë dhe shumë pak të njohur për vendin tonë.

Edukimi Mjedisor si Komponent i projektit të SeaMed-it

Vlorë 22-24 Tetor 2015 - Në kuadër të projektit “Aktivitete të qëndrueshme ekonomike në Zonat e Mbrojtura Detare të Mesdheut – komponenti për Shqipërinë”, INCA zhvilloi një trainim mbi Edukimin Mjedisor.

Trajnimi u mbajt në ambinetet e shkolles Naim Frasheri në Vlorë me një pjesëmarrje prej 32 mësuesish nga i gjithë rrethi i Vlores dhe përfaqësues të DAR Vlorë. Në fund të trainimit

mësuesit u pajisën edhe me një certifikatë më një kredit. INCA është një organizatë jo fitimprurëse, e akredituar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës me


numer Regjistrimi CA 013, për të zhvilluar modulet e trajnimit të punonjesve arsimore në përputhje me rregulloren për Sistemin e Akreditimit të programeve të trajnimit.



Mblidhet Komiteti Drejtues i Projekteve MedPartnership dhe ClimVar&MIZB

Athinë, Greqi, 3-5 Nëntor 2015 – U mbajt në Athinë takimi i 5-të dhe i fundit i Komitetit Drejtues të projekteve MedPartnership dhe ClimVar&MIZB nën moton "Aktivitetet e implementuara në një vend për të eliminuar ndotjen në Mesdhe, janë të dobishme për të gjitha vendet e tjera".

Në takim mori pjesë edhe Presidenti i INCA, Z.Genti Kromidha i cili ndër të tjera prezantoi edhe punën e bërë për shpalljen e Zonës së Mbrojtur Detare "Gjiri i Porto Palermos - Llamani" si dhe rrezultatet konkrete të punës së bërë në Zonën e Mbrojtur Detare "Karaburun-Sazan" në kuadër të projektit "Aktivitetet e qëndrueshme ekonomike në zonat e mbrojtura detare të mesdheut"



INCA merr pjesë në Konferencën "The State is Us"

Mynih, Gjermani 4-5 Nëntor 2015 - INCA mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare "The State is Us" Protest against Large-Scale (Construction) Projects in Southeast Europe.

Vendet e zgjedhura dhe rastet studimore që u prezantuan në konferencë dhanë informacion mbi format e rezistencës kundër llojeve të ndryshme e në shkallë të gjerë (ndërtimi) të projekteve të zbatuara në kundërshtim me ruajtjen e mjedisit dhe të zhvillimit të qëndrueshëm.

Këto prezantime ishin fokusuar: Në Bullgari, projekte të mëdha të ndërtimit të industrisë turistike shpesh provokojnë protestë; Në Rumani, protestat kundër projekteve të mëdha minerare kanë tërhequr vëmendjen e opinionit publik; Në Shqipëri projektet e lidhura me ndërtimin e hidrocentraleve të vegjël, si dhe pyetje në lidhje me ruajtjen e ekosistemeve nga mbetjet të rrezikshme) paraqesin çështje të rëndësishme të protestës.



Raport Progresi për Shqipërinë -Më shumë vëmëndje ndaj mjedisit

Integrimi i Shqipërisë në BE është një rrugëtim që kërkon përkushtim për plotësimin e kërkesave të *acquis* hap pas hapi dhe kjo detyrë monitorohet në mënyrë të vazhdueshme nga komisioni evropian. Monitorimi dhe rezultatet që arrihen në procesin e plotësimit të kërkesave për të gjitha fushat e përcaktuara pasqyrohet në raportet e progresit që për qeverinë shqiptare nuk janë gjë tjetër veçse një pasqyrim i hapave të ndjekura dhe progresi i arritur në realizimin e detyrave.

Ky proces përfshin tre komponentët kryesore që janë: transpozim, fuqizim dhe zbatim të legjislacionit përkatës duke u mbështetur në direktivat kryesore të BE dhe në mundësitë reale të plotësimit të kërkesave që rrjedhin prej tyre në kushtet e vendit. Për pjesën e transpozimit Shqipëria ka bërë përparime të dukshme dhe mund të themi që legjislacioni ynë e në veçanti ai horizontal mjedisor ka transpozim të të gjitha direktivave kryesore që ruajnë, mbrojnë dhe monitorojnë kushtet mjedisore dhe përdorimin e menaxhimin e mjedisit dhe burimeve natyrore. Vit pas viti progres raportet kanë evidentuar përparime për transpozimin e legjislacionit të BE, por kanë tërhequr vëmëndjen në fuqizimin e tij (fokusuar në pjesën institucionale) dhe sidomos për zbatueshmërinë e tij ku procesi është shumë i ngadaltë dhe vlen të theksohet që për disa ligje është i ndaluar.

Progresi raporti i këtij viti, 2015, megjithëse jep një progres pozitiv në realizimin e detyrave në fushën e

mjedisit dhe ndryshimeve të klimës, përsëri thekson “Shqipëria është në stadin fillestar të përgatitjeve në këtë fushë. (Albania is at an early stage of preparation in this area.)”. Ndonëse ligje të rëndësishme për mbrojtjen e natyrës së egër janë miratuar në parlamentin shqiptar, në raport theksohet se mbrojtja efektive e zonave të dizenuara si të mbrojtura natyrore ende kanë nevojë të kenë garancinë e statusit të tyre. Investimet në hidrocentrale duhet të përputhen me detyrimet e mbrojtjes së natyrës në veçanti për zonat e mbrojtura dhe zonat me vlerë të lartë natyrore dhe që do të kryhen në përputhje me *acquis* e në veçanti me direktivat e vlerësimit të ndikimit në mjedis, të Zogjve, Habitave dhe Direktivën Kuadër të Ujit.

Kjo thekson rëndësinë e planifikimit dhe përdorimit të burimeve natyrore dhe të zonave të mbrojtura bazuar në plane të hartuara mirë, në bashkëpunim të ngushtë të gjithë aktorëve dhe mbështetur në kërkesat e kuadrit ligjor duke respektuar fushat e veprimit dhe përgjegjësitë respektive. Ky progres raporti i vë përpara qeverisë shqiptare detyrimin e përgatitjes me seriozitet të saj dhe strukturave përkatëse për fuqizimin e përgjegjësisë dhe zbatimin me korrektësi të këtij kuadri ligjor. Për pasojë detyra kryesore e saj është të koordinojë dhe shkëmbejë informacion midis aktorëve qendror dhe vendor për të siguruar mbrojtjen e natyrës dhe shfrytëzimin e saj në kushte racionale dhe miqësore me të.

Raport mbi vlerësimin e VNM-ve të hidrocentraleve në Europën Juglindore

Raport studimor rreth vlerësimit të cilësisë së studimeve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të projekteve të hidrocentraleve në Evropën Juglindore. Raporti arrin në përfundimin se mangësitë kryesore vijnë nga: (i) transpozimi i direktivave të BE-së nuk është ndjekur nga norma specifike, rregullore dhe udhëzime për zbatimin e plotë të kërkesave dhe direktivave; (ii) mangësitë më serioze vijnë nga mungesa e gjërë e zbatimit të standardeve e të procedurave nga autoritetet kompetente, si për shembull mungesa e konsultimit me publikun dhe

vendim-marrje transparente,(iii) ka edhe mangësi serioze në aspektin e çështjeve specifike të përmbajtjes për shembull studime të kufizuara në terren dhe përdorimi i të dhënave shkencore jo të përditësuara.

Raportimi nga Shqipëria është bërë në kuadër të projektit DASHI në bashkëpunim me INCA i cili ka përzgjedhur ekspertin që ka realizuar analizën e plotë të situatës dhe cilësisë së studimeve të VNM/VSM për HEC-et që janë projektuar dhe ndërtuar në rrjedhat ujore të lumenjve të Shqipërisë.

NJOFTIME

5 Dhjetor - Dita Botërore e Tokës

11 Dhjetor - Dita Ndërkombëtare e Maleve

- 1 - Raporti i plotë studimor rreth vleresimit të cilësive të studimeve të Vleresimit të Ndikimit në Mjedis të projekteve të hidrocentraleve në Evropën Juglindore
http://d2ouvy59p0dg6k.cloudfront.net/downloads/hidro_v6_webr.pdf
- 2 - Rrugëtimi drejt Parisit 2015 - për integrimin e çështjeve të NK në politikat dhe dokumentet strategjike të vendit.
http://www.inca-al.org/index.php?option=com_k2&view=item&id=438:rrugetimi-drejt-parisit-2015&Itemid=133&lang=sq
- 3 - Request for Proposals (RfP) for “Technical assistance to Albanian authorities in establishing a management system for the extension of the World Heritage property Natural and Cultural Heritage of the Ohrid Region.” This RfP is published under the project “Towards strengthened governance of the shared transboundary natural and cultural heritage of the Lake Ohrid Region” and can be accessed from the following link:
http://cmsdata.iucn.org/downloads/management_planning_expert_rfp.pdf
- 4 - Request for Proposals for “Development and implementation of a comprehensive capacity building programme for selected pilot protected area in Albania.” This RfP is published under the project "Strengthening capacity in National Nature Protection - preparation for Natura 2000 network," and can be accessed from the following link:
http://cmsdata.iucn.org/downloads/protected_area_capacity_development_expert_rfp.pdf
- 5 - MEDfOR applications are NOW open for Erasmus Mundus scholarships and self-funded students, for the 2016/2017 edition. Deadline: January 15th, 2016.
<http://www.medfor.eu/>
- 6 - Për të lexuar “*Ditari i Natyrës*” në vite...
http://www.inca-al.org/index.php?option=com_k2&view=itemlist&layout=category&task=category&id=15&Itemid=195&lang=sq

Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

• Rrjeti i Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi t'i publikoni në ditarin e saj elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 200 - 250 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia mban të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme. Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme. Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

• Ky botim është mundësuar nga një grant i dhënë nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri përmes programit SENiOR-A. Ky publikim paraqet pikëpamjet e autorit/autorëve mbi këtë temë. Këto pikëpamje nuk janë adoptuar apo aprovuar nga REC Shqipëri dhe nuk duhet të shihen si qëndrime të tij apo të Ambasadës Suedeze në Shqipëri. REC Shqipëri nuk garanton saktësinë e të dhënave të këtij publikimi e nuk mban përgjegjësi për përdorimin e tij.

Botim i Rrjetit të Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës / Redaksia: Ilirjan Qirjazi; Vilma Kadiu; Marinela Mitro

Rr. Islam Alla, Pall IVEA, Kati I, 1001, Tiranë; Tel/Fax: + 355 4 2231 437
www.inca-al.org; info@inca-al.org; www.facebook.com/inca.albania